



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Fatmir Krasniqi	21.05.2025	22.05.2025	2025/0387

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 20.05.2025, OE “Florije Jahaj”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2025/0387, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Florije Jahaj”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Hartimi i projektit detal i udhekryqeve ne disa pjese te qytetit , ne Arbane, Bazhdarhane , Dardani Hartimi i projektit detal per funksionalizimin e rruges Adem Jashari” me nr. të prokurimit: "622-24-6638-2-2-3", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 30,000.00 €. Vendimet e mëparshëm i OSHP - së, PSH nr.2024/0835 të lëshuar me datë 11.12.2024, vendimit PSH nr. 0077/2025 dt. 17.04.2025 .Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së

3/3

F02 Formulari Standard per rishqyrtim te vendimit ne AK

Neni 7 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Florië Jahaj**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Hartimi i projektit detal i udhëkryqeve në disa pjesë të qytetit , në Arbanë, Bazhdarhane , Dardani Hartimi i projektit detal për funksionalizimin e rrugës Adem Jashari**” me numër të prokurimit: “**622-24-6638-2-2-3**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Neni 71 i LPP-së

Neni 80 i LPP-së

Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

Neni 55 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

Vendimi i OSHP-së nr.0835/2024, i dt.11.12.2024

Vendimi i OSHP-së nr.0077/2025, i dt.17.04.2025

KRITERET PËR VLERËSIM

Tenderi Ekonomikisht më i Favorshëm

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Raporti i komisionit të ri-vlerësimit është ngrit në platformë me dt 06.05.2025

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

n/a

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

PSH nr.2024/0835; PSH nr. 0077/2025 dt. 17.04.2025

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Florije Jahaj**

Sqarim Hyrës

OE ankues në ankesën e parashtruar në OSHP ka ngritë pretendime ankimore të cilat paraprakisht janë trajtuar përmes ekspertizës nr 2024/0835 të dt.05.10.2024 dhe vendimit PSH nr.2024/0835 të lëshuar me datë 11.12.2024, vendimit PSH nr. 0077/2025 dt. 17.04.2025 me ç’rast pretendimet janë konsideruar si të bazuara, dhe sipas vendimit të OSHP-se nga AK ishte kërkuar që për aktivitetin e prokurimit të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës duke e kthyer lëndën në ri-vlerësim dhe lënda është trajtuar si çshtje e gjykuar “ res Judicata”.

Konstatimet për aprovim të pretendimeve ankimore si të bazuara janë sikur në ekspertizën me nr 2024/0835 të dt.05.10.2024 dhe vendimit PSH nr.2024/0835 të lëshuar me datë 11.12.2024, dhe vendimit PSH nr. 0077/2025 dt. 17.04.2025 Përkundër qe vendimet kanë rezultuar me ri-vlerësim nënkupton se pretendimet ankimore kanë qenë të bazuara dhe AK, ka pas për obligim që te evitoj shkeljet e konstatuara ne vendimet e PSH-së dhe ti korrigjoj ato përmes ri-vlerësimit, por AK nuk ka ndryshuar rezultatin me rastin e ri-vlerësimit.

Andaj, vlerësojmë se OE ankues, me të drejtë në pretendimet e tij ankimore e kundërshton Njoftimin mbi vendimin e AK-së sidomos arsytet e eliminimit të dhëna nga AK, për faktin se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 paragrafi 4 i LPP-se, nenin 56 paragrafi 3 i LPP-së nenin 1, nenin 7 të LPP-se, dhe nenin 72 paragrafi 1 për faktin se AK gjatë ri-vlerësimit të ofertave nuk ka marrë për bazë faze konstatimet ne vendimin nr 2024/0835 dhe vendimit PSH nr. 0077/2025 dt. 17.04.2025

Po ashtu në kuptim të nenit 29 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së Autoriteti Kontraktues ka pas për obligim që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të vendimit të njoftoj OSHP-në lidhur me rezultatin e procesit të rivlerësimit.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores se Punës se OSHP-së nr. 01/2022 paragrafi 2, Eksperti Shqyrtues konstaton se pretendimet ankimore janë të njëjta të cilat janë shqyrtuar në ekspertizën nr 2024/0835 të dt.05.10.2024 dhe vendimin PSH nr.2024/0835 të lëshuar me datë 11.12.2024 vendimit PSH nr. 0077/2025 dt. 17.04.2025 përmes të cilit është aprovuar ankesa e OE si e bazuar dhe lënda është kthyer në ri-vlerësim. Në përputhje me konstatimet e lartëcekura, vlerësojmë se në rastin konkret çështja të trajtohet si “ Res- Judicata”.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që lënda të trajtohet si çështje e gjykuar sipas vendimeve paraprake të OSHP-së.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**Florije Jahaj**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Hartimi i projektit detal i udhëkryqeve në disa pjesë të qytetit , në Arbanë, Bazhdarhane , Dardani Hartimi i projektit detal për funksionalizimin e rrugës Adem Jashari**” me numër të prokurimit: “622-24-6638-2-2-3, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Florije Jahaj**

Fatmir Krasniqi

